

Permbledhje e informacionit dhe konkluzionet

Save the children beson se arsimit duhet te jete i nje standarti te larte per te gjitha femijet, pavaresisht nga prejardhja e tyre etnike apo kulturore. Kjo do te thote Arsimim i cili te jete perfshires, qe t'i pergjigjet nevojave te nxenesit, qe te jete i lidhur me zhvillimin e tyre dhe te siguroje pjesmarren e gjere te nxenesve. E drejta e femijeve per te marre arsim mbart edhe nje obligim te rende per te rriturit dhe i takon agjensive shteterore ne pergjithesi qe te perhapin dhe te sigurojne qe arsimit t'iu pergjigjet nevojave te femijeve individuale dhe te jete i nje cilesie te shendoshe. Shteti duke siguruar sherbime ne fushen arsimore mund te kompensoje pjeserisht per shtresat e paprivileguara te shoqerise dhe per pabarazite qe mund te lindin per shembull, ne rethana varferie ose ne kushte te veshtira te familjes. Ne realitet terreni arsimor nuk eshte gjithmone ne nje nivel te caktuar, te pandryshueshem per shkak te faktoreve historike te pabarazise strukturore dhe te diskriminimit. Shkolla si vendi ku bejne pjese qytetaret me te rinj te komunitetit, te cilet perfshihen ne boten jashte ambientit te tyre familjar, ka shume influence ne formimin e pikpamjeve te femijeve per boten qe i rrethon ata per shpresat dhe aspiratat e tyre. Per kete arsye sistemet arsimore jane mjetet me te rendesishme dhe me me influence per qeverite e vendeve sepse ato sigurojne respekt per qytetaret me prejardhje te ndryshme kulturore dhe etnike. Gjithashtu shkollat mund te jene edhe vende konfrontimi ku ndeshen vlera dhe pikpamje te ndryshme mbi boten dhe ku vlerat e shumices mund te predominojne mbi te gjitha te tjerat.

Per kete arsye raporti me titull pse te mohohet nje e ardhme, pervec faktit se njeh rendesine e arsimit, qe konsiderohet si nga familja dhe nga komuniteti, e perqendron vemendjen dhe ne punen e qeverive per te siguruar sherbime arsimore ne perputhje me obligimet qe ajo ka, si ne planin kombetar apo nderkombetar si dhe obligimet ne fushen e ligjit dhe politikave. Kryesisht raportet pershkruajne cilesine e arsimit te sponsorizuar nga fondet e shtetit. Raportet shpjegojne faktoret si per shembull mundesia e gjetjes te ambienteve te shkollës, ekzistenca e pengesave financiare per te frekuentuar shkollën si edhe faktoret rrethanore te tilla si: siguria personale e femijeve, kur ata shkojne ne shkollë. Vleresimi yne per cilesine perfshin krahasime materiale, per shembull ne se femijet Rome, Jevgjite dhe Endacake, mund te perdorin pajisjet dhe ambientet njelloj si edhe femijet nga grupe te tjera etnike dhe ne se keto pajisje dhe ambiente kane te njejten cilesi. Ne gjithashtu shqyrtojme edhe cilesine e kurrikules dhe praktiken mesimdhënëse e cila duhet te jete e hartuar dhe e pershtatur sipas nevojave dhe aspiratave te femijeve Rome, Jevgjite dhe Endacake. Ky eshte nje zbulim qe pritet te behet nga mesuesit qe mesojne nxenes Rome dhe Endacake dhe nga eksperiencat e prinderve dhe femijeve si edhe nga objektivat e arsimit. Ne shqyrtojme ate qe quhet vertet praktike e mire dhe ne çfare mase ajo zbatohet ne arsimin publik ne te gjitha Evropën.

E drejta per arsim

“ Shkolla eshte e mire per te ardhmen” ne mund te arrijme diçka “

Vajze Rome 12 vjeçe nga Kroacia

Arsimi eshte ne vetvete e drejta themelore e njeriut si edhe nje mjet per te realizuar te drejtat e tjera. Eshte kyç qe mund te hape shume dyer. Mohimi i te drejtes per arsim mund te ndikojte dhe te cenoje te drejtat e tjera meqe pasojat e nje arsimi te paplote mund te jene dhenia e te drejtave civile ose politike si per shembull, e drejta e shprehjes ose e drejta per pjesmarrje politike, qe jane te xhveshura nga kuptimi dhe permbajtja. Aftesia per te gezuar te drejten e arsimit kur mungojne faktoret e tjere kufizues si diskriminimi i tregut te punes hap rruge per nje standart jetese te pershtatshme. Ajo krijon mundesi per marrjen e njohurive qe i duhen individeve per te zhvilluar te gjitha aftesite e tjera, per te bere zgjedhje, per te zhvilluar ndergjegjen politike dhe sociale dhe per te marre vendime me piksynime te qarta ne menyre qe te jetojne nje jete me dinjitet. Permbi te gjitha, arsimi ne kuptimin me te gjere te fjales jep mundesi individeve qe te perfitojne benefite me te gjera.

“Arsimi nuk e ka hequr identitetin tim prej endacaku. Ai te jep me shume shans per te gene i pavarur ne jete. Eshte e mundshme te marresh arsim dhe te jesh endacak.

Endacak, ne Angli

Madje edhe kur arsimi percaktohet me termat e se drejtes ai nuk garanton faktin qe te mos dhunohet kjo e drejte. Ndryshimet legjislative kane nje ndikim disi te lire ne jeten e individeve pa mekanizmat dhe burimet qe nevoiten per t'i vene ato ne jete.

Ne praktike, ekzistojne pengesa politike, ekonomike, ideologjike dhe kulturore qe i pengojne shume grupe femijesh te mos gezojne te drejten per arsim. Mundesia e burimeve dhe e pozicionit relativ te arsimit ne hierarkine e prioriteteve kulturore, sociale dhe ekonomike, te shtetit dhe familjes ose mund te kompromentojne te drejtat e femijeve per arsim ose mund t'i nxisin ato.

“Une nuk mund te shkoj ne shkollen e mesme sepse jam i detyruar te punoj menjehere sapo te kem mbaruar shkollen 8 vjeçare. Do te desheroja te mesoja me shume”.

Djale Rom 9 vjeç – Greqi

“Ti e le shkollen ne moshen 11-12 vjeç dhe me pas te gjithë presin qe ti te veprosht si i rritur. Ti mund te tallesh nga te tjeret sepse mban ende çanten e shkolles pas moshes 14 vjeç.”

Djale Endacak, Irlanda e Veriut

“Une kurre nuk kam ndjekur shkollen. Prandaj une perpiqem qe femijet e mi te ndjekin shkollen rregullisht.

Prind, Rom – Bosnje – Hercegovine

“Une nuk dua te jem ndonje gje. Di te bej buke dhe gjera te tilla. Mendoj kjo mjafton.”

Vajze Rome 9 vjeç e parregjistruar ne shkolle, Kroaci

“Kam dy femije dhe ata po mbarojne klasen e tete, por vetem njeri mund te shkoje ne shkollen e mesme. Eshte e kushtueshme”.

Nene Rome – Hungari

Mesues te mbingarkuar dhe me mungese burimesh dhe drejtore shkollash kane perjetuar vale te vazhdueshme reformash te njepasnjeshme, ne vitet e fundit dhe e dine se kerkesat e teperta, ralle shoqerohen me burime dhe mbeshtetje per te cilat ata kane nevojte, neqoftese duhet te vene ne jete ndryshimet ne menyre te sukseshme.

“ Me nje buxhet kaq te vogel ne nuk mund te arrijme asgje. Mundesi te barabarta jane thjesht fjale boshe. “

Mesuese kopshti – Hungari

Ne shume vende Evropiane, kerkesa per femijet e minoritetit me burime te ndryshme nuk konsiderohet aq legjitime sa per femijet nga grupet e shumices.

“ Ne kemi shkolle te tmerrshme, te tjeret kane shkolla te bukura me ngohje qendrore dhe me tryeza te bukura”

Femi, Rom – Rumani

“ Une nuk mendoj se ndonje nga S i dergon femijet e tij ne arsimin parashkollor. Ketu nuk ka arsim parashkollor. Pra si mundet nje femi Rom qe jeton ne S te krahasohet me vellain ose motren e tij, jo Rom”.

Mesues Rom, Maqedoni

“ Ata arsimohen sipas nje programi te shkurtuar qe eshte i ngjashem me programin per femije me veshtiresi ne mesim dhe me vone kane probleme nese duan te rregjistrohen ne shkollen e mesme. Femijeve u thuhet se kjo eshte me e mira per ta. Ne e ndiejme veten te pafuqishem.

Prind Rom – Kroaci

Perpjekje per te kerkuar te drejta per arsim ne kushte te barabarta me shumicen, nuk gjejne gjithmone mbeshtetje masive. Shpesh femijet jane perçuesit qe transmetojne gjithte paragjykimet e prinderve te tyre tek bashkemoshataret.

“ Me pelqen te shkoje ne shkolle, por femijet e tjere nuk na duan ketu ata na tallin. Une dua te behem mesuese dhe t’u mesoj gjithte femijeve shkrim e kendim. Neqoftese te gjithte Romet do te dinin te shkruanin dhe te lexonin, asnjeri nuk do te na tallte ne”.

Vajze Rome, 10 vjeçe-Greqi

“ U perpoqa njehere – dy vjet me pare- vazhdova shkollen dy jave---femijet shqiptare na sulmuan. Do te filloj shkollen perseri dhe do ta çoj deri ne fund. Dua te behem doktor”.

Djale 12 vjeç qe ndjek ciklin parashkollor ne Kosove.

Çfare permban nje “arsimim sipas nevojave”

“ Neqoftese nuk do te mesoja nuk do te dija te beja asgje”.

Femije Rom – Rumani

Ne Evrope vazhdimisht zhvillohet debat lidhur me kuptimin e arsimit sipas nevojave. Sistemet arsimore kane shume bashkepunetore dhe lind nevoja, “sipas nevojave te kujt apo lidhur me ke”? .

Te drejtat per arsim, nevojat dhe preferencat e femijeve shpesh pengohen nga nevoja ekonomike imediate te familjeve te tyre, nga preferencat kulturore ose fetare te komuniteteve te tyre, ose nga profilet ekonomike dhe ideologjike te qeverive te tyre.

Sigurimi i arsimit nga shteti influencohet nga konteksti kulturor, politik dhe ideologjik. Konsensusi i perhapur per deshire “per arsim per te gjithë” eshte ne fund te fundit nje zhvillim relativisht i vone. Vetem disa dhjetevjeçare me pare ky koncept ishte i perhapur ne shume vende Evropiane ku mendohej si i panevojshem arsimi i mesem per grate e reja dhe madje ne nje fare mase dhe i padesherueshem. Arsimi, pervec faktit se te jep aftesi dhe vlera te veçanta qe i desherojne te gjithë qytetaret, nga ana tjetër arsimi konsiderohet madje si nje mjet per te zhvilluar axhenden politike, sociale dhe ekonomike te qeverise dhe per t’ia transmetuar kete qytetareve me te rinj. Shembuj te tille perfshijne mesimin e historise, edukata fetare, arsimi per te drejtat dhe qytetarine e njeriut dhe transmetimin e pikpamjeve dhe vlerave si respekti per njerezit nga sfone te tjera kulturore: nje ndjenje e superioritetit kombetar dhe ne rastet ekstreme kjo njihet me emrin ksenofobi.

Eshte e nevojshme te behen ndryshime te vazhdueshme ne arsim sepse sistemet arsimore duhet vazhdimisht te pershtaten me nevojat e ndryshueshme te individeve dhe shoqerise. Qellimi i arsimit eshte te pergatise femijet dhe te rinjte per tu bere qytetare aktive. Per te bere kete arsimi duhet te zhvilloje potencialin e femijeve, duhet ti nxite ata te mendojne dhe reflektojne ne menyre qe te jene te afte te perballin situatat qe shkolla nuk i ka parashikuar.

Procesi arsimor eshte shume efikas kur ai mbeshtetet ne pikpamjet e gjithë njerezve qe jane kliente dhe konsumatore te sistemit arsimor, jo vetem ata te zyrtareve qeveritare, politikanëve dhe profesionistëve. Burokracia qe eshte e nevojshme per funksionimin e sistemit arsimor publik ne shkalle kombetare shpesh te çon ne gjendje te ngurte dhe ne mungese fleksibiliteti.

Nje faktor i rendesishem qe ka çuar ne politka te pasuksesshme dhe te papershtatshme ne edukimin e femijeve Rome, Jevgj dhe Endacake, nuk ka qene ne gjendje te vleresoje diversitetin e komuniteteve, kontekstin dhe historite e tyre, efektin gerryes te paragjytimeve qe kane ekzistuar per dekada ndoshta dhe per shekuj. Procesi i zhvillimit te politikave ne menyre te paevitueshme kalon nga vleresimi i rrethanave per individet, familjet dhe komunitetet drejt nje sere parimeve dhe masave te pergjitheshme. Ne rastin e komunitetit te Romeve, Jevgjiteve dhe Endacakeve, ky proces duket se ka lindur jo nga kuptimi i rrethanave te familjeve dhe te komuniteteve por nga disa mendime dhe rezultate te pritshme krejtesisht negative.

“ Ne fakt qeveria nuk e njeh situaten e femijeve Rome ne sistemin arsimor. Neqoftese pyetet qeveria per hollesira ju thjesht do te merrni pergjigje se ata nuk e dine. Vetem

kohet e fundit, qeveria ka filluar te mbledhe te dhena per nevojat e femijeve Rome, permes pyetsoreve qe jane derguar ne shkolla.

Eskpert ne fushen arsimore – Sllovaki

Per shume nga prinderit Rome, Jevgjite dhe Endacake qe jane intervistuar per raportin me titull Pse te mohohet nje e ardhme, thenia me e pergjithshme lidhur me arsimin ka qene se arsimi te çon drejt sigurimit te mjetit per te fituar jetesen.

“ per te shkuar diku ata duhet te mesojne. Por neqoftese shikon rreth e rrotull nuk mund te gjesh pune as si pastrues me shkollë tetevjeçare ne kohrat e sotme. Ka qene krejt ndryshe per brezin e prinderve te mi”.

Baba Rom – Hungari

“me pelqen te shkoje ne shkollë sepse me ndihmon per te gjetur pune ne te ardhmen”.

Djale Rom klasa e tete – Itali

Siç shihet pikpamjet e tyre koencidojne me pikpamjet e shume Evropianeve qe e kane preokupim perspektiven e femijeve te tyre ne nje shoqeri qe po ndryshon kaq shpejt ne planin ekonomik. Megjithate, si prinderit ashtu dhe femijet ishin te ndergjegjshem per diskriminimin e tregut te punes qe mbyll shume mundesi punesimi, prandaj shpenzimet dhe koha qe duhet per te marre arsim ne fund te fundit mund te mos sjelle benefitet e pritshme.

“ gjyshi yne, gjithmone i thoshte vellait tim te mos shkonte ne shkollë. Ai me thoshte te njejten gje edhe mua. Ai thoshte se shkolla eshte e padobishme ne se nuk mund te gjesh pune me pas”.

Vajze Rome 14 vjeç Serbi

Disa prinder, nuk jane te bindur se shkolla eshte vendi me i mire qe femijet te arsimohen meqe permbajtja e shkolles nuk eshte shume e lidhur me nevojat e shoqerise.

“ Ne shkollë kam mesuar vetem 10% te asaj qe di. Une kam mesuar nga prinderit e mi dhe nga leximi”.

Endacak, Skoci

Megjithese edhe ne rastet kur prinderit jane te bindur se shkolla permireson dhe jep me shume raste per te perballuar jeten, femijet rriten ne nje ambient ku ka shume pak mundesi punesimi, madje dhe per ata me shkollë.

“ Çme duhet shkolla. Ka profesore qe punojne ne treg. Shkoni dhe numerojini ata”.

Djale Rom 16 vjeç – Bosnje –Hercegovine

Megjithate femije te tjere qe jane rritur ne zona me papunesi te larte, ishin te mendimit se arsimi i rrit mundesite e tyre per punesim. Neqoftese ata nuk gjenin pune ne vend, kualifikimet do t'i jepnin mundesi per te kerkuar pune ne vende te tjera.

“ Une nuk do ta beja arsimin te detyrueshem per te gjithë Romet dhe do t’i beja prinderit pergjegjes per t’i derguar femijet e tyre ne shkolle. “

Student universiteti Rom –Rumani

“ Dua te shkoj ne kolegji ne Arabine Saudite dhe te behem doktor atje”.

Djale 13 vjeç –Kosove

Eksperienca e perbashket Evropiane

Ne te gjithë Evropën, pavaresisht nga kulturat e ndryshme, kontekstet dhe historite, nga cilesia dhe aftesia e femijeve ose te rriturve, komunitetet Rome, Jevgjite dhe Endacake ndeshen me diskriminim, me sherbim me te ulet, me mungese te sigurise personale, me lirine e levizjes dhe zgjedhjes.

Mungesa e mekanizmave efikase i ben individet te pafuqishem dhe mosbesues ndaj strukturave zyrtare dhe institucioneve. Ne shume komunitete varferia dominon duke theksuar kete pafuqishmeri dhe duke rritur shkallen e izolimit social dhe ekonomik. Breza te tere e shohin veten te perjashtuar nga mundesite per arsim dhe si te zene ne kurth persa i perket nje punesimi qe shpesh eshte i pasigurt dhe me page shume te ulet.

Diskriminime dhe steriotipe

Diskriminimi qe hasin femijet Rome, Jevgjite dhe Endacake eshte shpesh fare i hapur. Raporti i Greqise, per shembull, refuzojne t’i çojne femijet e tyre ne te njejten shkolle me femijet Rome. Raporti i Anglise pershkruan raste se si nxenesit Endacake caktoheshin ne dhoma te veçanta per mbremjen e Krishtlindjes. Ka edhe forma te tjera me te sofistikuara te diskriminimit institucional nga ana e mesuesve dhe profesionistev te tjere qe jane po kaq te demshme dhe manifestohen hapur ne tere komunitetin Rom, Jevgjit dhe Endacak dhe mbartin konsiderata negative per aftesine e tyre per te mesuar. Ne shume vende te Evropes qendrore dhe lindore mesuesit kane reaguar ndaj perpjekjeve per te bere kete ndarje duke kerkuar pagese ekstra ne rastin kur ata i japin mesim femijeve Rom.

“ Une kam patur disa shoke cigane ne shkolle. Une e kuptoja qe ata trajtoheshin ndryshe. Ata duhet te punonin me shume qe te arrinin diçka dhe shpesh ata poshtroheshin”.

Nje i ri Hungarez

Ne te gjithë Evropën mbahet nje qendrim steriotip ndaj ciganeve. Ngandonjehere jane pozitive, shpesh negative, por ne te gjitha rastet bazohen ne paragjykime. Ne nje interviste te koheve te fundit presidenti i Sllovakise ka theksuar per shembull, se femijet Rome, per shkak te kushteve te varfere te jeteses duhet te dergohen ne shkolla me konvikt dhe te arsimohen per shembull per muzike, pasi ata jane shume te mire ne muzike.

“ Mesuesja ime do qe une gjithmone te kendoj per te duke thene se te gjithë Romet dine te kendojne”.

Djale Rom 8 vjeç ne Maqedoni.

“Shume prinder i mbajne femijet e tyre ne shtepi pasi kane frike se per aresye sigurie, policia i nxjerr endacaket jashte brenda disa diteve”.

Gazeta Londineze “ evening Standard” 5 Qershor, 2001

“ Mesuesit kane thene se femijet mund te mbajne edhe arme. Kjo eshte vertet shqetesuese”.

“ une nuk dua qe vajzat e mia te shkojne ne shkolle. Gjithmone degjohen thashetheme se femijet endacake krijojne trazira dhe une nuk dua qe femijet e mi te shoqerohen me ta”

Prinder te cituar ne te njejtin artikull

Lajmet kane fokusin e tyre, kriminalitet dhe sjellje te dhunshme dhe kur artikujt shprehin diçka pozitive theksi vihet mbi muziken dhe aftesite artistike. Ne median kryesore, romani popullor ralle portretizon individe Rome , Jevgjite qe kane te njejtat shqetesime dhe aspirata si dhe antare te tjere te komunitetit. Ne media dhe ne letersi artisitike populli Rom dhe Cigan pothuajse nuk pasqyrohet fare.

Femijet e kuptojne shume shpejt se njerzit jashte komunitetit te tyre i konsiderojne ata si te ndryshem dhe ne nje fare menyre inferiore.

“ do te doja te behesha pilot kur te rritem. Shpresoj njerezit nuk do te kundershtojne qe nje djale Rom te drejtoje nje avion”

djale Rom 10 vjeç Mali Zi

Pse duhet te kundershtojme ne dhe nga e di nje femije 10 vjeçar qe ne nuk do te ishim dakort qe ai te behej te mos behej pilot?

Ekziston nje numer i vogel i Rom/Jevgjit dhe Endacake te perfaqesuar ne profesione perfshire avokate, edukatore, politikane dhe aktiviste qe mbeshteten Save the Children ne pergatitjen e ketij Raporti. Nderkohe po lind nje gjenerate me aktiviste dhe gazetare te perkushtuar te cilet po fillojne te permbysin shume nga steriotipet qe sundojne mbare Evropën. Sidoqofte, Rom/ Jevgjitet dhe Endacaket akoma mbeten ne nje mase te madhe te paevidentuar ne fushen e politikave formale dhe berje e politikave.

“ Ciganet nuk jane te interesur per arsim” Kjo eshte nje thenie qe shpesh keqperdoret per te menjanuar çeshtjet e rendesishme rreth problemit pse prinderit shpesh hezitojne ti lene femijet e tyre ne duart e edukatoreve. Ky argument, gjithashtu sugjeron se komunitetet e Romeve dhe Jevgjiteve dhe kulturat e tyre shpesh ngrihen ne kohe dhe jane te pandryshueshme, nje pikpamje qe eshte e pavertete per keto komunitete si dhe per çdo komunitet ose kulture tjeter ne Evropën bashkekohore.

“ Shume njerez qe jane endacake thone se eshte e gabuar ti dergosh femijet ne shkolle. Ata kane frike se femijet do te humbin kulturen e tyre por une e di se menyra e jeteses se endacakeve po ndryshon dhe femijet kane nevojë per arsim per ti pergatitur per te ardhmen”.

Prind nga komuniteti Endacak- Angli

Ky mendim i perhapur gjeresisht eshte jo vetem i pavertete per shume prinder dhe femijet e ketyre komuniteteve por gjithashtu nuk lejon dhe identifikimin e nevojave per te shqyrtuar arsytet pse disa prinder dhe femije tregojne mosbesim dhe cinizem. Per hartimin e raportit: Pse te mohohet nje e ardhme, prinder dhe femije ne komunitete dhe vende te ndryshme shprehen shume pikpamje. Pikpamja e prinderve per shkollimin formal shpesh reflektonte eksperiencat e tyre te kaluara per arsimin dhe nese ato u kishin sherbyer kur u rriten.

Shume femije na kane thene se ata kenaqen duke mesuar dhe jane te vendosur te vazhdojne pavaresisht nga pengesat e shumta. Eshte mire te shkosh ne shkolle por nuk ka kush me zgjon ne mengjes. Mamaja ime shkon ne treg per te punuar ne oren kater te mengjesit dhe mua shpesh me ze gjumi. Kur zgjohem eshte vone dhe une ndihem i turperuar. keshtu une do t'i kerkoj nenes time te me bleje nje ore me zile”

Nje djale Rom, 10 vjeç, Bosnja dhe Hercegovina

“ Une kepus qersHITE, mamaja ime i lan ato dhe ne mbremje mbas shkolle, une shkoj dhe i shes ato (me qellim qe) te blej fletore, kepuce, veshje.”

Vajze Rome, Rumani

“Kur erdhem ketu tre vjet me pare, mendova se do te shkoj ne shkolle rregullisht por une nuk kisha deftese nga shkolla e vjeter dhe nuk munda te rregjistrohem. Une punoj ne mortuarin e qytetit. Vellai im dhe une endeshim duke lypur”

djale Rom , 14 vjeç, ndjek qendren e edukimit per te rritur ne Mal te Zi

“Une isha nje nga me te miret ne klase. Une punoja nje here ne jave per para dhe mesuesit me thane se nuk mund te kthehesha me ne shkolle, por drejtori i shkolles tha se une kisha te drejte te kthehesha. Une ngarkoja çimento – familja ime kishte nevojë per para”.

Djale Egjyptian, 14 vjeç – Kosove

Ngandonjehere prinderit dhe femijet kane pikpamje te ndryshme per vendin qe ze arsimi ne prioritetet e tyre personale dhe familjare.

“ Kam nje vajze qe do te shkoje ne shkolle te mesme por prinderit nuk e lejojne. Ata duan qe ajo te qendroje ne shtepi dhe te beje pune. Keto femije jane viktime e prinderve te tyre”.

Mesuese – Sllovaki

Shpesh ndodhin tensione mes brezave kryesisht ne disa familje. Shume prinder e mbeshtetin edukimin e femijeve te tyre, shpesh ne rrethana kur sistemi arsimor nuk i mbeshtet.

“ Do te doja te behesha mesuese. Nena ime deshiron qe une te ndryshoj shkolle, sepse ajo thote se kjo eshte e vetmja menyre per mua te behem mesuese”

Vajze Rome, 11 vjeçe, Shkolle Speciale per femije me te meta mendore – Republika Çeke

“ Natyrisht ja vlen te studiosh. Sa me shume te dish aq me mire eshte.”

Baba Rom – Hungari

Ndikimi i Diskriminimit per pranim ne arsim

Steriotipet predominuese ndikojne ne politikat shkollore perkundrejt femijeve Rome, permbajtjes se kurrikules se Romeve si edhe aspiratat dhe sjelljet e mesuesve.

“Ne shkolle, femijet Rome trajtohen ndryshe nga te tjeret. Ata nuk perpiqen t’i mesojne femijet tane “.

Prind, Rom. Shqiperi

Paragjykimi reflektohet ne steriotipe shpesh rezulton ne ndarjen fizike te femijeve Endacake, Jevgjite dhe Rome. Kjo dukuri shfaqet ne faktin se shume femije Rome, te cilet ndjekin shkolla speciale per femije me paaftesi mendore ne vendet e Evropes Qendrore dhe Lindore, jane diagnostikuar si te paafte mbi bazen e testeve te inteligjences (IQ) me prirje gjuhesore. Ngandonjehere testi i inteligjences nuk merret parasysh dhe mjafton nje rekomandim nga mesuesi ose drejtori i shkolles. Varferia i detyron prinderit te pranojne nje praktike qe edhe te aftit te kanalizohen ne rrjedhen e puneve qe u mohon atyre zgjedhjen per te vazhduar shkollen e mesme, universitetin ose nje pune drejtuese. Raporti i Bullgarise pershkruan praktiken e stafit te nje shkolle speciale i cili rekruton femije nga komuniteti Rom, duke u shpjeguar prinderve se si femijet qe ndjekin kete shkolle te veçante perfitojne ushqim dhe libra falas, perndryshe prinderit duhet te paguanin per to.

Ne shume vende, prinderit jo-Rome, kane protestuar kur ka patur plane per te shkrire shkollen Rome me ate jo-Rome dhe kane insistuar qe femijet Rome te mesohen ne klasa te veçanta. Madje dhe ne klasat e integruara ku ndodhen femije nga te gjitha shtresat, praktika e vendosjes se femijeve rome ne fund te klases eshte e zakonshme .

“ Une nuk e di pse ata rrine ulur ne forme rrethi (ne nje shkolle tjeter qe une vizitova). Tryezat e tyre jane ne forme rrethi. Por ne klasen time une ulem mbrapa te gjithëve dhe ngandonjehere nuk mund te shoh si duhet se çfare shkruan mesuesi ne derrase”.

Femije Rom, 7 vjeç, Maqedoni.

Ngacmimi i femijeve Rome nga shoket e tyre te klases jo-Rome shpesh nxitet nga prinderit e tyre. Dhe kjo eshte nje dukuri shume e shpeshte qe ne e konstatojme me dhimbje. Ne shume vende, mesuesit, pavaresisht se mund te kene qellim te mire, nuk jane te trainuar si duhet per t’i trajtuar keto incidente te ngacmimeve te vazhdueshme raciste. Ne kete drejtim eshte e qarte, qe mungon krejtësisht mbeshtetja per mesuesit.

“ Po punoja mire ...por kur e pane se kush isha une, filluan te me tallnin dhe nuk donin te uleshin prane meje. Sa here qe ndodh kjo, humbet perqendrimi per punen per çdo gje, pasi ti humb besimin. E di, diçka e keqe do te ndodhi çdo dite. Me pelqente te shkoja ne shkolle kur kjo gje nuk ndodhte por tani qe ndodh, une nuk dua te shkoj me ne shkolle”.

Endacak, Angli

Tashme praktika negative per te portretizuar ne libra shkolle kopertina te hapura ose tregime me titullin “ Jevgjiti volli pulen” , pak a shume nuk perseritet me. Romet dhe Endacaket ralle duken ne faqet e librave dhe mjeteve te tjera qe perdoren ne klase edhe kur demonstrohen tipa nga grupet e minoritetit. Edhe kur ekzistojne tekste te pershtatshme ato nuk perhapen gjeresisht. Pothuajse, nuk ka referenca ne kurrikulen baze persa i perket historise te popullit Rom dhe pjesmarrjes se tyre ne procese kyçe te rendesishme. Pervec ekzistences te nje dokumenti qe e ka origjinen qe prej 600 vjetesh. Perpjekjet per te futur kurrikul me te pershtatshme qe te perputhet me nevojat e femijeve Rome, jane bere nga prinder Rome por nuk jane marre parasysh. Ne republiken Çeke, prinderit u frymezuan kur ne nje rast ishin futur ne procesin mesimor kenge dhe valle per femijet Rome. Prinderit diskutuan se jo vetem qe femijet e ndiejne veten te respektuar ne shkolle por nga ana tjeter ata krijuan mendimin se femijet e tyre ndoshta ishin te afte per te ndjekur kurrikulen baze. Prinderit kishin shpresuar se per femijet e tyre mund te shtoheshin edhe disa mesime matematike shtojce. Nje feste kulturore e rastesishme nuk e transformon kurrikulen perjashtuese ne nje kurrikul perfshirese.

Sherbim me cilesi me te ulet

“ Ne kete shkolle nuk mesohet asgje. Nuk ka klase te mjaftueshme , ne studiojme me tre turne, mesuesit nuk çajne koken. Kush arrin te shkoje ne nje shkolle bullgare , domethene, jo ne shkolle te ndare per femijet Jevgjite, pothuajse gjithmone e perfundon ate. Ndersa ketu vetem disa nxenes e mbarojne klasen e tete çdo vit. Ata mund te kerkojne para per te derguar femijen ne nje shkolle Bullgare”.

Nxenes Rom, 15 vjeç, shkolle Rome, Bullgari

Raporte e vendeve me titull *Pse te mohohet nje e ardhme*, perfshin si vendet me te varfera ashtu dhe vendet me te pasura te Evropes. Pavaresisht nga gjendja e pergjithshme ekonomike, arsimi shteteror, strehimi, sherbimet mjekesore, qe u ofrohen Romeve , Endacakeve dhe Jevgjeve, jane te nje standarti me te ulet se sherbimet qe i ofrohen shumices te popullates. Kjo dukuri eshte e vertete si per vendet shume te pasura ashtu dhe per ato te varfera.

Shembujt e cituar ne raportet e vendeve perfshijne: Mbylljen e shkollave dhe kopshteve ne komunitetet e Romeve dhe Jevgjiteve, ndersa shkollat dhe kopshtet e tjera nuk mbyllen; nuk ka vende te lira per vendosjen e Romeve dhe Jevgjiteve dhe as nuk ka plane per te shtrire transportin dhe infrastrukturen ne pergjithesi; godinat e shkollave kane nje cilesi me te ulet ne komunitetin Rom dhe Jevgjit.

Nje shqetesim i vazhdueshem eshte se shume sherbime jane planifikuar dhe vazhdimisht planifikohen per te permbushur nevojat e shumices se popullates duke perjashtuar grupet komunitare. Keshtu per shembull, madje dhe ne zonat me popullate te shtuar Rome, nuk ka staf ne departamentin e strehimit qe te flase gjuhen Rome. Po keshtu nuk ka asnje person qe flet gjuhen Rome ne qendren shendetesore, shkolle ose kopesht. Aresyet per kete dukuri perfshijne, diskriminimin e tregut te punes, kerkesat arsimore per aplikantet,

per postet e sektorit publik dhe kulturen institucionale te cilat perjashtojne perfshirjen e ketij komuniteti.

Pervec kesaj institucionet e sherbimeve publike shpesh zhvillojne nje kulture qe sherben per vete perdoruesit, qe ata te perfitojne sa me shume njohuri, aftesi gjuhesore dhe te tjera qe u nevoiten atyre per te bere sherbime zyrtare. Kjo gje çon ne nje forme racionale te diskriminimit.

“ Nuk ka libra, nuk ka mesues qe e njohin gjuhen Rome, dhe ka pak Rome qe dine te shkruajne ne gjuhen e tyre. Keshtu nuk eshte e mundur te gjenden mesues”

Stafi i Oraganizates Joqeveritare-Shqiperi

Mungojne gjithashtu sherbimet ne dy gjuhe ose ne shume gjuhe. Kjo nuk perjashton komunitetin Rome dhe Jevgjit. Pajisja e shkollave me mesues qe punojne me femije nga prejardhje te ndryshme gjuhesore do te ndihmonte shume nje numer te madh femijesh. Eshte krejtesisht e pranueshme qe femijet te cilet dine shkrim e kendim ne gjuhen e tyre amtare, jane ne gjendje te aplikojne keto aftesi dhe per gjuhe te tjera, me lehte, me me lehtesi se sa femijet qe bejne perpjekje per te mesuar shkrim e kendim ne nje gjuhe qe ata nuk e kuptojne ose nuk e flasin mire.

Une nuk kuptoj Kroatisht mire dhe nuk e di se çfare me thone, nuk di si t’iu pergjigjem qe ata te me kuptojne mua sepse fjalet e mia jane fare te paqarta. Kjo eshte shume e veshtire per mua, sepse ata mendojne qe une nuk di asgje. Por kjo nuk eshte e vertete. Eshte me e lehte per mua te bej vizatim, por une do te doja te behesha police., por per tu bere police une duhet te shkoj ne shkollë.

Vajze Rome, 9 vjeç Kroaci

Disa faktore qe ndalojne perfshirjen ne institucionet arsimore.

Infrastruktura e dobete e transportit midis vendbanimeve Rome dhe qendrave te medha te sherbimeve kufizojne mundesite e femijeve per te marre dije ne shume menyra. Prinderit jane te shqetesuar per sigurine fizike te femijeve te tyre kur ata udhetojne ne distanca te gjata dhe ne rruge te ndriçuara keq. Shpesh nuk ka linje transporti publik per disa kilometra. Problemi eshte me shqetesues ne kohe te keqe kur femijet nga familje te varfere nuk kane veshje te ngrohta apo kepuce dhe femijet duhet te ecin ne rruge gjithë balte. Nje studim qe eshte bere per femijet Rome dhe qe eshte cituar ne raportin e Kroacise tregon se shumica e femijeve shpenzon me shume se nje ore per te shkuar ne shkollë. Mungesa ose mbyllja e sherbimit parashkollor ne komunitetin Rom dhe Evgjit ose ne vendbanimet Nomade mund te çojne ne faktin qe vajzat me te rritura ta lene shkollen per te ndihmuar ne rritjen e femijeve me te vegjel kur prinderit jane ne pune. Keshtu qe nenat nuk kane zgjidhje tjeter vetem t’i heqin vajzat me te rritura nga shkolla.

“ Kisha nje vella me te vogel dhe te dy prinderit e mi punonin keshtu qe nuk kishte se kush te kujdesej per te. Une nuk shkoja ne shkollë rregullisht, keshtu qe e lashe fare. Me vjen keq qe nuk mund te shkoj ne nje shkollë tani. Do te doja te kisha mundesi te shkoja ne nje shkollë te mesme dhe pastaj te gjeja pune te mire”.

Une kisha te njejtin problem, me duhej te kujdesesha per motren time me te vogel. Mbarova vetem gjashte klase dhe gjashte vjet me pare e lashe shkollen. Interviste me dy gra Egjiptiane , 21 vjeçe , qe ndjekin klasat e te prapambeturve ne Kosove.

Shume sisteme shkollore ne Evrope kerkojne qe femijet te bejne detyra shtese ne shtepi. Femijet jetojne ne kushte te veshtira dhe ne familje me shume pjestare dhe qe shpesh nuk kane as uje dhe as ndriçim, e kane te veshtire, pothuajse te pamundur te bejne detyra shtepie. Ky disavantazh shtohet kur ata rriten dhe duhet me shume kohe dhe vend per te studjuar dhe per t'u pergatitur per provime. Itinerari eshte nje tipar i rendesishem per klasen punetore ne familjet Rome, Jevgjite dhe Endacake ne te gjithë Evropën. Disa familje udhetojne vetem ne vere per pune sezonale, te tjeret udhetojne gjate gjithë vitit. Ky aspekt i jetes se Romeve, Endacakeve dhe Jevgjeve, paraqet sfide te veçante qe eshte planifikuar per popullsi me vendbanim te qendrueshem. Raportet e Anglise dhe Rumanise citojne shembuj se si autoritetet ne fushen e arsimit publik po perpiqen te gjejne zgjidhje per trajtimin e ketyre sfidave. Mungesa e stafit Rom, Jevgj dhe Endacak, ne sherbimet arsimore krijon shume veshtiresi praktike si per shembull, paaftesia e stafit per te komunikuar me prinder dhe nxenes dhe pamundesia e tyre per te ditur cilat jane preferencat e tyre kulturore.

Mungesa e sigurise personale, e lirise se levizjes dhe zgjedhjes

Per te siguruar ndarjen midis komunitetit Endacak dhe nxenesve tane kemi krijuar nje zone te veçante permes se ciles femijet nuk duhet te kalojne.

Poster, ne shkolle Angleze, cituar ne gazeten Londineze Evening Standard, 5 Qershor, 2001.

Nderkohe qe mungon krejtesisht siguria personale per femijet Rom, Egjiptiane dhe Ashkali, ne Evrope, vazhdojne te shfaqen sulme te dhunshme ndaj individeve dhe komuniteteve nga grupe neonaziste ne Evropën qendrore dhe Lindore. Ngacmimet dhe sharjet me fjale jane pjese e nje eksperince te perditshme per Romet, Jevgjitet dhe Endacaket, gjithashtu dhe ne Evropën perendimore.

Per endacaket ne Angli dhe komunitetet Nomade kudo ne Evrope, largimi me force, mungesa e vendbanimeve te sigurta dhe e vendqendrimeve dhe armiqesia qe ushqen popullata e vendosur ndaj ketyre grupeve, ndikon shume ne frekuentimin e shkolles nga femije te ketyre komuniteteve.

“ Me qente e tyre fqinjët tane na e veshtiresojne vazhdimin e shkolles”

Vajze egjiptiane – Kosove

“ Me zgjoi policia duke goditur dhe shkaterruar shtepine time dhe te gjitha gjerat qe ishin brenda, veshjet dhe çanten e shkolles. Si mund te shkoj une tani ne shkolle”

Nje e re Rome qe pershkruan nje debim me force ne Itali

Ndikimi i mungeses se sigurise per arsimin

“Ne shkolle femijet tane jane rrahur dhe tani kane frike te shkojne ne shkolle. Disa nga femijet ketu shkojne ne shkolle, por shumica e kane lene”

Prind Rom, Shqiperi

Neqoftese prinderit kane frike per sigurine e femijeve te tyre, ata do ti mbajne femijet ne shtepi.

Neqoftese prinderit kane frike per sigurine e femijeve te tyre, ata do ti mbajne femijet ne shtepi. Ata nuk do ta dergojne femijen ne shkolle ne se nuk ka linja te sigurta transporti. Prinderit do te zgjedhin shkollen me te afert ose nje shkolle ku ka shume nxenes Rome, dhe kete gje do ta preferonin me shume se sa zgjedhjen e nje shkolle qe do ti jepte femijes se tyre arsimin e duhur. Ne disa raste prinderit do te preferonin te dergonin femijen e tyre ne nje shkolle speciale per femije me paaftesi sepse aty ka edhe femije te tjere Rome, madje edhe ne rast se femija e tyre nuk ka vertet paaftesi. Frika se femija e tyre do te keqtrajtohet eshte gjithashtu nje faktor perse ka pak frekuentim ne sistemin e kopshteve dhe çerdheve dhe perse vajzat e braktisin shkollen me shume se djemte. Nje rezultat llogjik dhe i rendomte i ketyre dy faktoreve eshte terheqja e vajzave nga shkolla per tu kujdesur per femijet me te vegjel ne familje.

“ Une nuk shkoj ne qytet, nuk kam qene kurre ne shtetitje, ne Bulevard, familja ime nuk do qe une te dal jashte, mbase ata kane frike sepse djemte me ngacmojne kur dal ne rruge” .

Nje e re Rome, Mali i zi

Mungesa e kontaktit midis komuniteteve te ndryshme qe ne moshe te re ben te mundur qe te zhvillohen me shume keto steriotipe dhe te rritet shkalla e mosbesimit reciprok. Ne kete menyre thellohet ndjenja e pasigurise dhe masat e ndermarra per te permiresuar kushtet ne shkolla dhe kopshte nuk japin rezultat, sepse femijet qe do te perfitonin ne shumicen e rasteve mungojne.

“Une mendoj se eshte e rendesishme qe femijet te qendrojne me komunitetin e tyre. Ne jemi te lumtur me njeri tjetrin dhe ndihemi me te sigurt keshtu siç jemi”

I ri Endacak, Irlanda e Veriut

Pervec kesaj perspektiva e dhunes dhe sharjeve me fjale influencon shume tek dinjiteti i femijes dhe tek ndjenja e aftesise se tij. Kufijte e botes “se sigurt” jane me te ngushta per femijet Rom, Jevgj dhe Endacake se sa per femije nga minoritete te tjera .

“Une thashe se ajo nuk mund te shkoje...une dua qe te ajo te shkoje ne shkollen prane. Ne rast se ka problem, une mund te shkoj vete ne shkolle dhe te takoj drejtorin.

Babai i nje vajze Rome se ciles i eshte ofruar nje kolegji.

“ Ata thonin se une isha mafioze, njeri prej tyre me qelloi me grusht ne fytyre. U ktheva dhe vrapova drejt e ne shtepi. Prinderit e mi u frikesuan dhe thane se une nuk do te shkoja

me ne ate shkolle. Une shkova perseri disa muaj me vone dhe ndodhi perseri e njejta gje. Ata me ndoqen por une u largova”

djale Rom 10 vjeç, Mali i zi

Klasat jane si komunitete ne vetvete me normat dhe kulturat e tyre. Kjo mund te shkaktoje veshtiresi per nxenesit qe vine nga distance e larget dhe familjet e tyre shpesh nuk mirepritin dhe nuk strehohen. Po te ishte nje ambient me mikpritjes dhe me nje mesues me miqesor qe e kupton kulturen tone kjo do te ishte nje ndryshim shume me pozitive.

“Ne te gjithë kemi probleme kur duam te gjejme pune. Ketu ne shkolle na trajtojne njelloj dhe ne menyre te barabarte”

Nje i ri Rom, Rumani, qe ndjek shkolle profesionale

Mungesa drejtesie

“ Ata nuk te thone se nuk e duan femijen sepse eshte cigan, ata te thone se ska vende. Si mund te zbulosh nese kjo eshte e vertete ose jo? Kujt mund ti ankoresh?

Studente Rom, ne nje shkolle Rome, Bullgari

Ne pothuajse çdo vend qe kemi studjuar gjendet te pakten nje kuader ligjor dhe nje kuader i politikave arsimore qe garanton te drejtat baze duke perfshire mundesi te barabarta, sherbim per te gjithë dhe drejtesi per te gjithë. Megjithate, kur flitet per politika te hapura te sherbimeve poshte standartit te kerkuar ndihet nje diskriminim institucional dhe popullsia Rome, Endacake dhe Jevgjite ka shume pak mundesi per ta ndier veten te besuar kur kerkojne drejtesi. Jane te shumta rastet qe perfshijne incidente te brutalitetit policor, diskriminim ne tregun e punes, raste te dhunes raciste, sherbime strehimi poshte standarteve te duhura dhe mbyllja e qendrave shendetesore ne komunitetin Rom kur ne komunitete te tjera te gjitha keto sherbime jane te hapura.

Vendosja Ombudsmanit, vendosja e sherbimeve keshellimore per qytetaret dhe perfaqesimi ligjor qe ofrojne Orgnizatate Joqeveritare – te gjitha keto jane zhvillime inkurajuese dhe nje numer i vogel i rasteve ligjore shenon nje fillim te suksesshem per te filluar ndryshime. Megjithate Rome, Jevgjite dhe Endacake kane ende pak mundesi per te kerkuar drejtesi, neqoftese njehere iu eshte refuzuar puna per shkak “te races se tyre” ose nese femija i tyre cilesohet i paafte menderisht ose si rezultat i nje testi inteligjence me prirje kulturore. Nje studim qe pershkruhet ne raportin e Sllovakise tregon eksperiencen e nje grupi 20 vjeçare Rome. Ajo sapo ishte kthyer nga shkolla baze, nga nje shkolle rehabilitimi per studente me paaftesi mendore. Ajo shpjegoi se do te desheronte te jepte provimin e fundit te cilin ajo nuk e kishte dhene ne kohen qe ndiqte shkollen speciale. Pas perfundimit te shkolles speciale te rehabilitimit ajo kishte vazhduar studimet e saj ne shkollen e mesme profesionale per kuzhinier dhe kamarier. Kjo lloj shkolle, nuk i jep asaj mundesine qe te jape provimin perfundimtar i cili do t’i krijonte asaj mundesi per te marre nje rroge me te larte, per te pasur nje post drejtues dhe per te vazhduar me arsimin e larte. Zevendes drejtori ne shkollen baze e kishte miratuar kerkesen e saj dhe i kishte thene organizates save the children: “rasti i saj eshte rasti tipik. Une ndoqa shembullin e

vajzes se burri im i kishte dhene asaj mesim ne shkollen speciale... edhe ai me raportoi mua se kjo vajze kishte testin e inteligjences mbi mesatare, problemi i saj i vetem ishte se prinderit e saj nuk kishin fare shkolle.

Ndikimi i mungeses se drejtesise

Mungesa e drejtesise ben qe te mos kete shume besim ne autoritetet publike dhe nenpunesit e sherbimeve shoqerore dhe ndikon shume ne çmobilizimin e energjive. Ne Europen Qendrore dhe Lindore pasojat me serioze per femijet ndodhin nga mungesa e drejtesise per ata prinder femijet e te cileve cilesohen si te “vonuar” dhe kjo ndodh se ato nuk e flasin gjuhen e vendit qe flet shumica e njerezve. Kohet e fundit nje grup prinderish Çek qe e humben çeshtjen ne gjykatën Çeke, do te hapi nje proces ne Gjykatën Europiane Te Drejtave te Njeriut. Ne rast se kjo çeshtje do te dale me sukses mijera prinder do te inkurajohen dhe femijet e tyre nuk do te quhen me te vonuar. Deri tani kjo sfide nuk ka rezultuar e suksesshme ne asnje vend ku dihet se shume femije Rom dergohen ne shkolla speciale dhe marrin arsim qe i perjashton ata nga shume profesione.

Varferia dhe perjashtimi nga shoqeria

“Do te doja te vazhdoja shkollen por prinderit e mi nuk kane shume para per librat dhe per gjerat e tjera qe me nevojiten”.

Kete e ka thene nje djale Rom 16 vjeç nga Bosnja –Hercegovine

Shume komunitete Rome, Jevgjite dhe Endacake ne vende te ndryshme kane nivel te larte papunesie dhe pasiguri ne pune, kane paga te ulta dhe pune me status shume te ulet dhe punojne ne vende pune te pasigurta me nje ekonomi te pastabilizuar. Kjo gje ndryshon nga vendi ne vend dhe per shembull, ne Evropën qendrore dhe lindore shume familje Rome e ndiejne se situata e tyre eshte perkeqesuar ndjeshem ne dhjetevjeçarin e fundit. Diskriminimi i vazhdueshem nxit levizshmerine sociale dhe shkakton varferi dhe skamje nga nje brez tek tjetri. Megjithese situata dhe kuadri mund te ndryshoje disi, ky eshte rasti tipik per gjendjen e ketyre komuniteteve ne Evropën perendimore, qendrore dhe juglindore.

Industrializimi dhe ulja e kerkeses per mjeshterite dhe zanatet tradicionale qe dikur i sillnin te ardhura familjeve Rome dhe Jevgjite ne Evropën Qendrore, Lindore dhe Juglindore ka pasuar rrjedhjen e ngjarjeve dhe ne kete dhjete vjeçar ku shume Rome dhe popullate Jevgjite humben vendet e tyre ne bujqesi, si edhe vendet e punes ne mjeshterite e tyre. Per Romet, Jevgjitet dhe Endacaket ne Evropën perendimore, ky tranzicion ka ndodhur me gradualisht. Ndalimi i aktivitetit privat ne shume vende te Evropës Qendrore dhe Lindore para viteve 1990 tregonte se ne kete rajon, ne ndryshim nga Evropa Perendimore nuk kishte mundesi per popullaten Rome dhe Jevgjite qe te gjenin pune tregu pa u diskriminuar, ndonese ata ishin te vetmit tregetare ose mjeshter qe i sherbenin komuniteteve te tyre.

Ne disa komunitete me zhvillim te shpejte ne Evrope, papunesia per popullaten Rome dhe Jevgjite mbetet 70-90%. Te ardhurat e zhvillimit ekonomik nuk arrijne deri ne komunitetet e Romeve dhe Jevgjitëve gje qe tregon se vetem zhvillimi ekonomik nuk

mund te garantoje fundin e varferise dhe perjashtimin social per keto komunitete. Eshte e nevojshme te behen perpjekje dhe investime shtese, per te mos lejuar diskriminimin dhe duhen marre masa te nevojshme per zhdukjen e ketij diskriminimi ne tregjet e punes. Ne te gjithë Evropën shume te rinj Rome, Jevgjite dhe Endacake nuk arrijne te perfundojne arsimin baze dhe eshte e sigurt se ata do te ndeshen me kufizime lidhur me zgjedhjen dhe perspektivat e tyre per punesim. Neqoftese kjo tendence nuk ndryshon, atehere varferia do te jete e paevitueshme edhe per shume dekada dhe breza te tjere.

Ndikimi i varferise mbi arsimin

“shume femije nuk vijne ne shkollë sepse nuk kane rroba te pershtatshme per te veshur dhe e ndiejne veten keq”

djale Rom, 10 vjeç, Greqi

Ne Evropën Qendrore, Lidnore dhe Juglindore, pershtatjet ne strukture kane rezultuar ne terheqjen e ndihmave dhe futjen e honorareve dhe pagesave te llojeve te ndryshme. Kjo ka qene shkaterimtare per sherbimet parashkollore dhe gjithashtu ka ndikuar dhe ne tekstet dhe materialet shkollore. Shpenzimet per transport jane nje tjetër barrë per familjet e varfera qe jetojne ne vendbanime shume larg qendrave te populluara. Ne rastin e familjeve teper te varfera, ky presion financiar ka detyruar shume prinder t'i heqin femijet nga shkolla. Mosfrekuentimi i ciklit parashkollor ne shume vende ka patur efekt te demshem per femijet me prejardhje dygjuhesore duke i lene ata ne disavantazh gjuhesor ne shkollën fillore, ku shumica e mesuesve nuk jane te pergatitur te punojne me femije qe nuk e flasin gjuhen e vendit. Varferia dhe papunesia e madhe ne komunitetet Rome, Jevgjite dhe Endacake ne gjithë Evropën ka sjelle si pasoje qe nje numer i madh femijesh ta lene shkollën me qellim qe te punojne ose ne rastin e vajzave te ndihmohen me pune shtepie kur prinderit punojne. Femijet fitojne aftesi gjate punes dhe keto aftesi ata nuk i transmetojne lehte ne ambientin e shkolles. Keshtu mbasi ata e kane lene shkollën dhe jane mesuar me pergjegjesine per te fituar te ardhura ose per tu marre me problemet e shtepise atehere ka shume pak mundesi qe keta femije te kthehen ne shkollë. Edhe ne rastet kur kthehen ne shkollë, ata jane me te rritur se femijet e tjere ne klase sepse shoket e tyre te klases kane ecur perpara ndersa keta kane mbetur mbrapa ne shume pjese te kurrikules dhe shprehite qe ata kane marre ne pune nuk vlejne me ne shkollë. Keshtu ata nuk ndiejne me kenaqesi ndersa puna ju sillte te mira materiale imediate dhe praktike ndersa te mirat e aktivitetit abstrakt siç eshte mesimi nuk jane kaq imediate, nuk jane kaq te prekshme dhe nuk te japin para. Femijet jane ne nje dileme tashme, ose te fitojne tani ose te behen nje fuqi fituese per te ardhmen.

“do te desheroja te vazhdoj shkollën por e di qe eshte e pamundur se tani me ka kaluar moshë. E nderpreva shkollën sepse nuk kishim mundesi financiare per te blere libra. Kjo ishte e vetmja arsye. Dhe mora nje vendim. Kjo ndodhi 5 vjet me pare. Do te desheroja te vazhdoja shkollën e mesme por nuk e di se si”

Vajze Egjiptiane, 15 vjeç, Kosove